

## REPORTAZH/ Shkrimtarët shqiptaro-amerikanë, një dashuri e re **Çmimi "Gjenima" për Letërsinë**



Nga GJEKË MARINAJ,  
TEKSAS

Më 20 gusht, 2006, anëtarët e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, mblidhen në krahët e hapur të Çikagos së bukur, për të sjellë me vete diçka të veçantë nga jeta e tyre letrare e personale, nga jeta e qyteteve ku banojnë, nga bota e pasur shpirtërore që kanë. Nëpërmes dyerve të hapura të zemrave bujare të vëllezërve Hodó dhe Sami Mehmeti, të cilët morën përsipër të gjitha shpenzimet e darkës, shkrimtarët dhe poetët e diasporës hynë brenda dyerve të restorantit Green Dolphin për të jetuar shijen e një nate të paharruar.

Mbi gjashtëdhjetë shkrimtarë, poetë e të ftuar nderi, në një sallë të bukur dhe komode, krijuan një atmosferë krejt shqiptare. Biznesmeni i suksesshëm Nazar Mehmeti, pritësit dhe përcjellësit, mikpritësit dhe argëtuesit Dalan a Burbuqe Luzaj, Pandi e Valbona Siku dhe Ymer Çela i përshëndesnin të ardhurit, një nga një, me dashamirësinë tipike të shqiptarëve për shqiptarët. Ishin aty shkrimtarja Teuta Shabani Tovvel, Sonila Luzaj, Evgjëni Sevo e Merita Bajraktari McCormack, poeti Sami Milloshi, Mëshill Velaj, shkrimtari Ramiz Gjini, poetët Lekë Gjoka e Luigj Çekaj. Bisedat e tyre plot mall e kuriozitet për jetën dhe krijimtarinë e gjithësecilit do t'i ndërpriste zëri i Dalan Luzajt. Pas një urimi të ngrohtë mirëseardhës, ai ja dorëzoi mikrofonin aktorit tonë të shquar Pandi Siku. Që nga momenti që ai e mori në dorë mikrofonin gjërat që tradicionalisht kërkoheshin seriozitet u gërshetuan me një humor të këndshëm. Mbizotëroi serioziteti kur u prezantuan të ftuarit e nderit. Ata ishin shkrimtarja kanadeze Constance Rookë, poeti gjerman Rainer Schulte, shkencëtari shqiptar (nga nëna), profesor në universitetin e Çikagos, Miodrag Radulovalçki dhe Prof. Dr. Zenum Halili, i ardhur nga Universiteti i Prishtinës. Pas pak minutave të shoqëruar me muzikë, recitime poezish

dhe mes ca grimcave humoristike, e mori fjalën ai që është "shtylla kurrizore" e gjithë mbarëvajtjes së shoqatës, pra kryetari i shoqatës, shkrimtari vërtet i talentuar Ramiz Gjini. Gjini theksoi se mbi të gjitha, anëtarët e shoqatës gjendeshin aty "për t'i shtrënguar dorën njëritjetrit si njerëz". "Ne," tha ai, "e kemi konsideruar dhe do ta konsiderojmë lidhjen tonë si një grupim kolegësh e miqsh të një ideali. Nuk na ka bashkuar asnjë interes, por na ka bashkuar ndjenja humane, dëshira për ta ruajtur dhe përsosur më tepër atë konstrukt shpirtëror, pa të cilin, populli ynë nuk do të mbijetonte... Lidhja jonë, është sot një nga grupimet më serioze shqiptaro-amerikane".

Më tej vuri në dukje disa nga aktivitetet që shoqata ka zhvilluar gjatë vitit që kaloi. Ai përmendi promovimin e librave të poetit dhe skulptorit Nexhat Ymeraj, i cili ia dhuroi shoqatës të gjitha paratë që u grumbulluan atë ditë nga shitja e librave të tij. Gjini vlerësoi gjithashtu bashkëpunimin e shoqatës me Vatren, veçanërisht një prezantim të serisë së librave mbi mendimin shqiptar, të botuara në Tiranë. Si të rëndësishëm e trajtoi edhe një aktivitet përkujtimor mbi jetën dhe veprën e regjizorit kosovar Besim Sahatçiu, të organizuar në studion e fotografit të njohur Fadil Berisha. "Kemi arritur brenda një viti," tha ai, "të botojmë të vetmen antologji të poetëve shqiptaro-amerikanë, të cilën sonte e kemi në dorë." Ramiz Gjini shtoi se kohët e fundit, ka pasur një interes të madh të shkrimtarëve dhe poetëve për t'u anëtarësuar në lidhje duke respektuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë një anëtari. Ai përmendi si emra krijuesish seriozë Merita Bajraktari McCormack, Kozeta Zylo, Pandeli Simsia, Iliriana Sulkuqi, Nexhat Ymeraj, Selahudin Velaj, Gjergj Lakuqi, Evis Maria Xhajanka, Vlash Fili, Bardhyl Mezini, Ymer Çela etj., të cilët janë anëtarësuar këto kohët e fundit. Ramiz Gjini bëri të qartë se "Ashtu siç ka pasur anëtarësime të reja, ka



Kryetari Ramiz Gjini me Rozi Theocharin



Nga festa në restorantin Green Dolphin

pasur edhe nga ata, që si të thuash, janë vetë-përjashtuar, pasi nuk u janë përgjigjur detyrimeve, ndonëse, përmes kësaj forme, në kemi afruar edhe mundësinë e anëtarësimit falas. Por, para se të bëhet kjo, duhet rezervuar në kryesi kërkesa, e cila, është e përfshirë në dispozitat që përmban kjo formë. Në e kemi bërë këtë për të evituar rrezikun e shndërrimit të lidhjes sonë në një organizatë fantazmë, e kemi bërë, sepse nuk duam të gënjejmë as veten as opinionin publik."

Pas fjalimit të kryetarit, vërtet të respektuar nga shoqata dhe komuniteti, filloi shtrimi i darkës. Gjithçka kaloi në një atmosferë kaq miqësore, kaq shqiptare sa vetëm kameramani Eduart Çausi, i cili bëri filmimin e të gjithë mbrëmjes për televizionet që do e transmetojnë aktivitetin, mund t'i diktonte.

Një ndër surprizat e tjera të natës ishin edhe të ftuarit e nderit. Midis tyre ishte edhe poeti gjerman Rainer Schulte, poezitë e së cilit i kemi lexuar të përkthyer në shqip nga libri "Ora e Paqes". Schulte lexoi disa nga poezitë e tij në anglisht

për të pranishmit. Të njëjtat poezi u lexuan në shqip nga poetë e shkrimtarë të ndryshëm. Të gjitha poezitë, në të dyja versionet, u duartrokritën me entuziazëm nga pjesëmarrësit. Kënga dhe vallja, recitimet dhe përshëndetjet vazhduan deri pas mesnatës. E shtuna që sapo kaloi mund të poetizohet si e "shtuna e madhe".

Madhështia nuk qëndron vetëm tek sakrificat, por edhe tek besimi që anëtarët e shoqatës kanë në këtë bashkim të madh. Është më mirë të mos u tregoj se autori i të gjitha këtyre sakrificave është poeti ynë i mirënjohur Dalan Luzaj. Vërtet diktatura komuniste ia ka thyer brinjët nëpër kampet e internimit atij dhe familjes së tij për vite të tëra, por shpirti u ka mbetur aq i thellë dhe i kthjellët sa ç'është vetë deti i Vlorës. Ta lemë me kaq, sepse sakrificat për miqtë Dalani i quan privilegje personale, dhe mund të lëndohet. Shkrimtari i talentuar Ymer Çela, që nga e shtuna në mëngjes deri të hënën më mbrëmje, e rezervoi limuzinën për ta vënë atë në shërbim të kolegëve dhe miqve të tij krejt falas.

### "PERËNDIM I MALLUAR"

Një tjetër surprizë e këndshme ishte edhe Antologjia poetike "Perëndim i Malluar", e përgatitur me shumë kujdes nga Dhori Thanasi dhe botuar në Shqipëri nga shtëpia botuese "Arbëria". Në antologji marrin pjesë 62 autorë të sotëm dhe 12 nga e kaluara që nga Konica, Noli, Pipa, Peshkëpia, Xhaferrri e të tjerë pak, ose aspak të njohur, me krijime të viteve të hershme nga shekulli i kaluar. Natyrisht, shumë nga poezitë e botuara aty as që i afrohen nivelit antologjik, por Thanasi dhe konsultantët e tij kanë gjykuar që antologjia të jetë më tepër një përmbledhje e krijuesve të diasporës se sa të përpiqeshin të përzgjidhnin esencën poetike të poezisë që është krijuar dhe krijohet në diasporën tonë. Një vendim ky që pati reagime të ndryshme nga anëtarët e shoqatës. Në këtë antologji; nga e kaluara janë përfshirë: Arshi Pipa, Bilal Xhaferrri,

Elpiniqi Q. Frashëri, Faik Konica, Theofan S. Noli, Haxhi M. Çami, Nexhat Peshkëpia, Lukë Grabocka, Kristo Floqi, S. I. Dhëmbeli, Spiro Dino, Vass Peppo. Ndërsa lista e poetëve bashkëkohorë përbëhet nga: Abdurrahman Thaçi, Adnan Mehmi, Agim Baceli, Albana Liftchin, Alfred Lela, Ani Gjika, Artan Fili, Bardhyl Mezini, Betim Muço, Blerta Alikaj, Dalan Luzi, Dedë Shkurti, Dhori Thanasi, Donika Timko, Edmond Ismailati, Ejvis Maria Xhajanka, Fatbardha Pali, Fatjon Paja, Fotjon Thanasi, Gazi Buxheli, Gentian Blaca, Gjeto Turmalaj, Gjekë Marinaj, Ilir Levonja, Ilir Borova, Iliriana Sulkuqi, Julia Gjoka, Kolec Traboini, Këze (Kozeta) Zylo, Lekë Gjoka, Lulash Palushaj, Luljeta Blaca, Maksim Zotaj, Mensur Spahiu, Merita Bajraktari McCormack, Mëshill Velaj, Mustafa Elezi, Ndrek Ded Guri, Ndue Hila, Nexhat Imeraj, Nexhip Ejupi, Niko

Kirko, Pal Imeri, Pal Ndreçaj, Petraq Pali, Përparim Hysi, Qazim Rushaj, Rajmonda Moisiu, Ramiz Gjini, Roland Musta, Rozi Theohari, Sami Gjoka, Shpëtim Kastrati, Tahir Hysa, Vaid Hyzoti, Valbona Dardha, Valentina Gervokaj, Valter Kozma Lazëri, Yllka Nika, Zef Përgega, Zeqir Gërvalla dhe Zera Bajgora. Sipas Thanasit, për këtë veper "u shfrytëzuan materiale të dërguara prej autorëve, bashkëpunëtorëve dhe u shfletuan shumë vëllime poetike. Për autorët e brezit të hershëm në Amerikë u përdorën materiale arkivore dhe periodikë të botuar prej shqiptarëve në fillimshkullin e shkuar".

#### Çmimin "Skënderbeu" e

#### meritoi Nazar Mehmeti

Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë për herë të parë nderon me çmimin Skënderbeu një nga njerëzit më shpirtgjerë

të komunitetit shqiptar të Amerikës, biznesmenin e shquar Nazar Mehmeti. Çmimi "Skënderbeu" jepet në shenjë falënderimi ndaj ndihmës që jepet për financimin e çmimit "Gjenima", i cili ka për mision sjelljen e njërit nga shkrimtarët më të mirë në botë në takimin e shoqatës, dhe që andej njohjen e shoqatës në botën letrare ndërkombëtare. Vitin që kaloi, zoti Mehmeti përveç mbulimit të shpenzimeve të darkës së shtruar në nder të shoqatës në Dallas, që mendohet të ketë kushtuar rreth 5000 dollarë, i dhuroi shoqatës edhe një çek prej 2,500 dollarësh. Nazar Mehmeti është i vetmi, që di unë, që aktivizon rrethin e tij familjar dhe miqtë e tij për ta drejtuar ndihmën e tyre aty ky vërtet ia vlen. Ai jo vetëm që e ndihmon shoqatën, por edhe e ndjek veprimtarinë e saj nga afër. Këtë vit erdhi në Çikago një ditë para takimit, që të sigurohej se gjithçka do të vinte mbarë ditën e diel.